



Pranuar / Dorezuar Prenjevoj / Predatu Received / Delivruy	09.03.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	1261/2022		1/6



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.104/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.104/2022 të datës 09.02.2022 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me [redacted] në Prishtinë, kundër Vendimit me Nr.1250/2021 të datës 17.11.2021 të Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 09.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.104/2022 e datës 09.02.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted]
- II. **SHFUQIZOHET** Vendimi me Nr.1250/2021 i datës 17.11.2021 i Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
- III. **DETYROHET** Sekretarja e Përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë zbatimin e këtij vendimi, duke e kthyer ankuesen në vendin e punës Menaxhere e Njësisë së Burimeve Njerëzore sipas Akt Emërimit të datës 11.01.2013.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 17.11.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. 1250/2021 me të cilin ka bërë caktimin e ankueses si Zëvendësuese e Udhëheqësit të Qendrës për Akomodim në Departamentin për Ri integrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të huajve, deri në marrjen e një vendimi tjetër.

Ankuesja përmes emailit këtë vendim e ka pranuar më datë 17.11.2021, mirëpo më datë 18.11.2021 ka njoftuar Zëvendësuesen e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme se vendimin do ta zbatoj edhe pse është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Ankuesja kundër Vendimit me Nr.1250/2021 të datës 17.11.2021 të Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 09.02.2022 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:629/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.02.2022 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Ministria e Punëve të Brendshme. Këshilli më datë 24.02.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:629/2022 të regjistruar me numër A.nr.104/2022 e datës 09.02.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.1250/2021 të datës 17.11.2021 të Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Akt Emërimit e datës 11.01.2013 në emër të ankueses; Emailin e datës 18.11.2021 nga ankuesja; Emailin e datës 17.11.2021 nga _____ për ankuesen; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 01.02.2021, 09.01.2019 dhe 16.01.2018; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 18.02.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 24.02.2022; Emailin e datës 21.02.2022 nga _____ Raporti i Auditimit me Kërkesë Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore 2021; Kërkesë për shtesë në pagë e datës 03.09.2008 nga ankuesja; Kartela e Nëpunësit në emër të ankuese e datës 24.02.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankueses është e bazuar, sepse:

Bazuar në shkesat e lëndës, gjegjësisht Akt Emërimit e datës 11.03.2013 është konstatuar se ankuesja është e punësuar në pozitën "Menaxhere e Njesisë së Burimeve Njerëzore" në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.1250/2021 të datës 17.11.2021 të Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, pretendon që në këtë rast ku vendim është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, sepse vendimi nuk ka këshillë juridike, nuk janë cekur arsyet mbi bazën e të cilave është nxjerr ky vendim si dhe mungon afati se kur duhet të anulohet apo shfuqizohet i njëjti.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në Vendimin me Nr.1250/2021 të datës 17.11.2021 të Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme me të cilin ankuesja është caktuar Zëvendësuese e Udhëheqësit të Qendrës për Akomodim në Departamentin për Ri integrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve, si arsyet është theksuar që me qëllim të funksionalizimit të kësaj qendre bëhet ky caktim pasi që edhe kjo është pozitë e lirë dhe nuk është dhëna asnjë arsyet tjetër, ndërsa në bazë të përgjigjes në ankesë të datës 24.02.2022 të dërguar nga Ministria e Punëve të Brendshme theksohet që: *“Auditori i Brendshëm i MPB-së, më kërkesë ka bërë auditim të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MPB-së nga data 08.06.2021 deri më datë 07.07.2021 për periudhën kohore 2019 dhe 2021. Ky auditim në NJBNJ. Ka konstatuar të gjetura të konstatuar si: Mungesa e Plasnit afatmesëm, tejkalimi i afatit me ushtrues detyre apo zëvendësues, kompensimet e DIEKP si sekretari, kompensimi për rrezikshmëri, mungesa e koordinimit për trajnime dhe koeficienti i zyrtarit jo në pajtim me pozitës. Në mesin e të gjeturave ishte shtesa për rrezikshmëri prej 107 eurove që e gëzonte znj. Bruçi nga data 03.09.2008 deri më datë 23.07.2021...Zëvendësuese e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme në bazë të gjeturave të Raportit të Auditimit të Brendshëm ka nxjerr Vendimin me Nr.1250/2021 të datës 17.11.2021 të Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme me të cilin ankuesja është caktuar Zëvendësuese e Udhëheqësit të Qendrës për Akomodim në Departamentin për Ri integrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve...”*.

Bazuar në këtë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme Vendimin me Nr.1250/2021 të datës 17.11.2021 për caktimin e ankueses Zëvendësuese e Udhëheqësit të Qendrës për Akomodim në Departamentin për Ri integrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve, nuk e ka bazuar në asnjë pikë në Raportin e Auditimit të Brendshëm siç pretendohet në përgjigjen në ankesë, kështu që me këtë përgjigje është tentuar që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të vihet në lajthitje.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankueses, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke marr për bazë përgjegjësit e Sekretarit të Përgjithshëm, konstaton se Qendrës për Akomodim në Departamentin për Ri integrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve për nga hierarkia është e barasvlershme me pozitën e udhëheqësit të divizionit, në këtë rast meqenëse pozita e udhëheqësit të kësaj qendre është e lirë, atëherë sipas nenit 20 paragrafi 3 të Ligji Nr. 06/1-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, përcaktohet që: *“Udhëheqësi i divizionit, në rast të mungesës, zëvendësohet nga nëpunësi civil i nivelit më të lartë i të*

njëtit divizion. Në rast se ka më shumë se një nëpunës civil të njëtit nivel, ai zëvendësohet nga nëpunësi civil i nivelit më të lartë, që ka përvojë më të gjatë në Shërbimin Civil. Në rast pamundësie shëndetësore të udhëheqësit të divizionit, zëvendësimi caktohet nga drejtori i departamentit”, ndërlidhur me këtë neni 32 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka përcaktuar se: “Përjashtimisht, një pozitë e rregullt pune në Shërbimin Civil mund të plotësohet në rast të nevojës të zëvendësimit apo mungesës së përkohshme të një nëpunësi civil varësisht nga rasti, për një periudhë jo më të gjatë se 12 (dymbëdhjetë) muaj. Në këtë rast, procedurat e pranimit zhvillohen nga Njësia e Burimeve Njerëzore, në pajtim me rregullat e përcaktuara me këtë ligj për nëpunësin administrativ dhe mbështetës”, në këtë rast nuk janë përfillur këto procedura, sepse zëvendësues mund të caktohet një nëpunës civil vetëm në rastet kur nëpunësi që mban pozitën aktuale, përkohësisht nuk mund të ushtoj atë pozitë, por kjo asesi nuk mund të bëhet kur pozita është e lirë, dhe kjo duhet të bëhet përmes procedurës së paraparë më nenin 32 paragrafi 4 Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ndërlidhur me 79 dhe 80 të këtij ligji.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të Vendimit me Nr.1250/2021 të datës 17.11.2021 të Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka konstatuar se ky vendim nuk përmban elementet e aktit administrativ, të përcaktuar me nenin 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse në pjesën hyrëse nuk janë përcaktuar saktë baza ligjore e nxjerrjes së këtij vendimi, në pjesën urdhëruese apo dispozitiv nuk është treguar afati se për sa kohë do të prodhojë efekte juridike ky vendim, ndërsa arsyetimi është i paqartë dhe nuk është i mbështetur në asnjë fakt juridik, ndërsa tek pjesa përmbyllëse nuk ky vendim nuk ka informatë për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike), sipas paragrafit 1.1 deri 1.4 të këtij neni.

Sipas Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, arsyetimi i Vendimit me Nr.1250/2021 të datës 17.11.2021 të Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është i pa qartë dhe kontradiktor dhe në kundërshtim sepse është marr pa u mbështetur në asnjë provë juridike dhe është në kundërshtim me nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe po ashtu në kundërshtim me paragrafin 2 të këtij neni i cili përcakton se: *“Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”*. Po ashtu sipas këtyre Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Vendimi me Nr.1250/2021i datës 17.11.2021 i Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafët 1.3, 1.4, 1.5, 1.6 dhe 1.7 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj anulimi i këtij vendimi bëhet me qëllim për të vendosur ligjshmërinë siç parashihet me 55 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Një akt administrativ i paligjshëm për arsye të tjera nga ato ta parapara nga neni 54 i këtij Ligji, mund të anulohet apo të shfuqizohet, me qëllimin për të vendosur ligjshmërinë”*.

Lidhur me pranueshmërinë së ankesës së ankueses të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, është bazuar në nenin 127 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj”*, andaj lidhur me këtë i u kemi referuar edhe nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Bazuar në këtë, lëvizja e nëpunësve civil për interes të institucionit në kategori të njëjtë mund të bëhet vetëm sipas dispozitave të nenit 52 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, andaj pretendimet ankimore të ankueses janë të bazuara.

Bazuar në të lartcekurat, Sekretarja e Ministrisë së Punëve të Brendshme, është e obliguar që ta kthej në vendin e punës Menaxhere e Njësisë së Burimeve Njerëzore sipas Akt Emërimit të datës 11.01.2013 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës që rrjedhin sipas akt emërimit.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *“Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”*, ndërsa me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të këtij ligji është përcaktuar se: *“Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit”*.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.104/2022

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses [REDACTED]
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.